



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Data: 08.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe duke u bazuar në nenin 63 të Rregullave për prokurim publik të ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.11.2022 të parashtruar nga **OE El Bau SH.P.K. nga Gjilani**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit”** me nr. të Prokurimit **613-22-11238-5-2-1**

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim, **OE El Bau SH.P.K. nga Gjilani**, me titull: **“Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit”** me nr. të Prokurimit **613-22-11238-5-2-1**

Vërtetohet Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit të publikuara në platformën e prokurimit të datës: 14.10.2022. dhe formulari B54 për korigjimin e gabimeve të datës 01.11.2022

1. **Mbetet në fuqi** Njoftimi për kontratë dhe Dosja e Tenderit të datës: 14.11.2022. dhe formulari B54 për korigjimin e gabimeve të datës 01.11.2022
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me aktivitetin e prokurimit të lartpërmendur.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

OE El Bau SH.P.K. nga Gjilani, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e infrastrukturës së rrugëve dhe trotuareve në Komunën e Lipjanit" me nr. të Prokurimit 613-22-11238-5-2-1. Lidhur me kushtet e pjesëmarrjes të parashtrura nga AK.

Pergjigje per pretendimet e juaja.

Kërksa juaj refuzohet sepse AK gjate zhvillimit te procedurave pikerisht kushtet per pjesmarrje i vendos duke u bazuar ne rendesine e projektit dhe ligjeve te LPP, dhe ne asnje rast AK nuk vendos kriteret diskriminuese per OE, disa nga kerketat vetem jane ndrruar dhe jane publikuar ne platformen e prokurimi.

Kerketat e parashtruara jane te bazuara ne projektin (paramasen) ne fjale. Duhet te ju njoftojme qe kemi te beje me nje projekt qe zgjate 36 muaj dhe qe te gjitha nga mjetet e parapra dhe stafi udheheqes jane me se te nevojshme per kete projekt dhe jane mjete qe lidhen me projektin ne fjale poashtu duhet te ju sqarojme qe per qdo pune qe do te realizohet kerkohen mjete adekuate per punen e caktuar sepse eshte kontrate, e mirembajtjes dhe nevojitet qe punet te realizohen ne menyre profesionale ne terren.

Pretendimet tuaja jane te pa bazura dhe kerkesa juaj eshte refuzuar.

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP


Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

AK ka vepruar konform rregullave per prokurim publik neni 63, 63.1.1 pika b.

Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit**, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit.

Bekim Shabani



Drejtor i Prokurimit